



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17 regjistër (JR)
Datë 05.05.2023

Nr. 35 i vendimit
Datë 27.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 27.07.2023, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2023 (JR), datë 05.05.2023, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, me detyrë ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 645, datë 11.04.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore, përgjegjëse e Sektorit të Studimeve, Kërkimeve, Analizës dhe Integritit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, prej datës 13.01.2015 deri më datë 01.02.2017, datë kjo në të cilën Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. {***}, datë 01.02.2017, e ka emëruar oficere të policisë gjyqësore. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, referuar paragrafit 11 të vendimit të Komisionit objekt ankimi, ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Trupa gjykuese e ngarkuar me kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Ornela Xhembulla, u caktua nëpërmjet procedurës së shortit në datën 15.06.2021.
4. Me vendimin nr. {***}, datë 21.06.2021, trupi gjykues vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit nga relatori.
5. Në datën 01.03.2023, vëzhguesi ndërkombëtar i ngarkuar për çështjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, ka depozituar në Komision një gjetje në kuadër të kompetencave të tij të parashikuara në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, me anë të së cilës ka pasur për qëllim të informojë trupin gjykues të çështjes në Komision mbi përgjigjet e përcjella zyrtarisht me *e-mail* nga Prokurori i Përgjithshëm, z. O. Ç., ndaj pyetjeve dhe kërkesave të vëzhguesit ndërkombëtar, lidhur me sqarimin e detajeve të procesit administrativ që e kanë bërë znj. Ornela Xhembulla të largohet apo heqë dorë nga pozicioni i saj si ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
6. Me vendimin nr. {***}, datë 10.03.2023, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, sipas relacionit të paraqitur nga relatorja, njoftimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, lidhur me të drejtën e saj për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe të drejtat procedurale që ajo gëzon në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017. Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk është përcjellë në Kolegj, por fakti i dorëzimit të deklaratave për të tria kriteret e vlerësimit referohet nga Komisioni në vendim.

7. Me vendimin nr. {***}, datë 17.03.2023, “Për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla”, trupi gjykes vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, seancë e cila u caktua të zhvillohet më datë 20.03.2023, në orën 10:00. Subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me sa më sipër nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* më datë 17.03.2023, ora 12:40.
8. Në të njëjtën datë 17.03.2023, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, ka përcjellë në rrugë elektronike, në adresë të Komisionit, prapësimet e saj lidhur me raportin e Komisionit mbi procesin e rivlerësimit, si dhe ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në seancën dëgjimore të caktuar më datë 20.03.2023.
9. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni, më datë 06.04.2023², mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, dhe ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt rivlerësimi, me vendimin nr. 645, datë 11.04.2023.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

10. Komisioni, me vendimin nr. 645, datë 11.04.2023, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, vendosi:
 1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ornela Xhembulla.*
 2. *Ndalimin e emërimit të znj. Ornela Xhembulla si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.*[...]

III. Shkaqet e ankimit

11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, më datë 26.04.2023, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 645, datë 11.04.2023, me pretendimin se ky vendim është marrë në cenim të së drejtës së subjektit për një proces të rregullt ligjor dhe si pasojë e zbatimit të gabuar të Kushtetutës dhe vlerësimit të gabuar të fakteve dhe provave.
12. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e saj, të vendosë:
 - ° *Ndryshimin e vendimit nr. 645, datë 11.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe deklarimin e përfunduar të procedurës administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen.*
13. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

² Referuar pjesës hyrëse të vendimit objekt ankimi, pasi konstatohet se në fashikull mungon procesverbali i marrjes nga Komisioni të vendimit nr. 645, datë 11.04.2023.

13.1 Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornella Xhembulla, pretendoi se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e cënimit të së drejtës për t'u mbrojtur në mënyrë efektive.

13.2 Komisioni nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimit.

13.3 Vendimi i Komisionit nr. 645, datë 11.04.2023, është marrë në zbatim të gabuar të Kushtetutës dhe si pasojë e interpretimit të gabuar të fakteve e provave nga Komisioni.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Ornella Xhembulla, dhe për të cilin nëpërmjet ankimit kërkohet ndryshimi i tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh³, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e

³ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 645, datë 11.04.2023, për rivlerësimin e subjektit, znj. Ornella Xhembulla, i është njoftuar asaj me shkresën nr. {***} prot., datë 12.04.2023, konfirmuar sipas lajmërimarrjes më datë 13.04.2023, në të cilën rezulton se vendimi i është dorëzuar vetë subjektit të rivlerësimit, si dhe ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 26.04.2023, protokolluar në Komision në të njëjtën datë, me nr. {***}, që rezulton të jetë dita e 13-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 645, datë 11.04.2023, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke e kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

17. *Lidhur me shkakun e ankimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të cenimit të së drejtës për t’u mbrojtur në mënyrë efektive*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimmarrja e Komisionit është e paragjykuar, në shkelje të së drejtës për informim, të së drejtës për mbrojtje efektive, parimeve dhe parashikimeve të vendosura për procesin e rivlerësimit kalimtar në ligjin nr. 84/2016 dhe ato të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, seanca dëgjimore u caktua pa pritur dërgimin nga subjekti të prapësimeve mbi “Raportin e lidhur me procesin e rivlerësimit”, apo pa kaluar afati i ngushtë i vendosur prej Komisionit për këtë qëllim. Në përfundim, Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk e zhvilloi seancën dëgjimore më datë 20.03.2023, sikundër as e shpalli vendimin e tij publikisht, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, por vetëm e publikoi atë më datë 12.04.2023. Subjekti pretendoi se në kundërshtim me nenin 57, pika 3, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit nuk përmban mendimin e shprehur nga subjekti i rivlerësimit, të bërë me dije me përgjigjet e rezultateve të hetimit, por është mjaftuar vetëm me përmendjen e faktit të dorëzimit nga subjekti të parashtrimeve. Në kuadër të pretendimeve në mbështetje të këtij shkakun ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi edhe se koha e lënë në dispozicion nga ana e Komisionit, vlerësuar në raport me kohën e marrë nga ky i fundit për zhvillimin e kësaj procedure, është tepër e kufizuar, duke i vendosur asaj një barrë dukshëm joproporcionale, në raport me konkluzionin përfundimtar të procesit ndaj subjektit, si në aspektin e rezultateve të parashtruara në raport, ashtu edhe në atë të pritshmërive të saj profesionale në vijim.
18. Fillimisht, sa i takon pretendimit të subjektit për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës, nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, nuk është bërë asnjë kërkesë për shqyrtimin e ankimit të saj ndaj vendimit të Komisionit në seancë gjyqësore publike, me qëllim riparimin e shkeljeve procedurale të pretenduara.
19. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakun ankimi, trupi gjykues, pasi vlerësoi aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, në kuadër të procedurave të zhvilluara në Komision sa u takon çështjeve të parashtruara më sipër nga subjekti, konstatoi se çështja e rivlerësimit që i përket subjektit, znj. Ornela Xhembulla, ishte shqyrtuar mbi bazë dokumentesh më datë 06.04.2023, ndonëse për këtë çështje, referuar vendimit nr. {***}, datë 17.03.2023, të trupit gjykues të

Komisionit, ishte caktuar zhvillimi i seancës dëgjimore publike në datën 20.03.2023. Në përfundim, Komisioni kishte shpallur vendimin objekt ankimi më datë 11.04.2023.

20. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të administruar në Komision, sa i takon procedurës së ndjekur në rivlerësimin e subjektit, znj. Ornela Xhembulla, trupi gjykues vërejtë se me komunikimin elektronik të datës 10.03.2023, në adresën zyrtare të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i ishte drejtuar kësaj të fundit: *1. Referuar nenit 46, 47 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues i përbërë nga [...] ju njofton lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit nëpërmjet raportit bashkëngjitur këtij e-maili. Në përfundim duket se në rastin tuaj, jemi para aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Lutemi gjeni bashkëlidhur këtij e-maili qëndrimin e Komisionit. [...] 3. Ju keni të drejtë të paraqisni prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, brenda datës 17.03.2023. 4. Pas dërgimit të parashtrimeve tuaja, ju do të njoftoheni për datën dhe orën e seancës dëgjimore të Komisionit lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit.*
21. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, në komunikimin e saj të datës 17.03.2023, ora 15:02, ka njoftuar Komisionin mbi dërgimin e prapësimeve të saj ndaj raportit të Komisionit mbi procesin e rivlerësimit, duke theksuar edhe: *Gjithashtu ju bëj me dije se nuk do të marr pjesë në seancën dëgjimore të caktuar në datë 20.03.2023, ora 10:00. Në parashtrimet e saj, dërguar Komisionit bashkëlidhur e-mail-it të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk pajtohet me qëndrimin e Komisionit, duke iu referuar në mënyrë të shprehur paragrafit 20 të raportit të Komisionit, në të cilin ky i fundit ka konkluduar: [...] Në këtë kuptim, duket se Komisioni është në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për subjektin Ornela Xhembulla, në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës – dhe se paraqet në vijim arsyet për shkak të të cilave vlerëson se ky qëndrim i Komisionit duhet të ndryshohet. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, pasi ka argumentuar qëndrimin e saj në lidhje me këtë çështje, ka konkluduar: Për sa më sipër, përfundimi i marrëdhënies sime të punës si ndihmëse ligjore, nuk ka ndodhur për shkak të dorëheqjes, por për arsye ligjore. Për pasojë, bazuar në nenin 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 [...], sipas të cilit: “Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi im i rivlerësimit nuk duhet të ndërpritet bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Në kushtet kur, sa paraqitet në raport, çon në konkluzionin se Komisioni do të vendosë për procesin tim të rivlerësimit mbështetur vetëm në trajtimin e statusit të subjektit, vlerësoj se përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurës Administrative, është zgjidhja e duhur dhe e drejtë ligjore.*
22. Në analizë të fakteve të konstatuara në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni, me komunikimin e datës 10.03.2023 dhe bërjes me dije të rezultatit të pritshëm të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me administrimin e shpjegimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit në kundërshtimin e raportit të Komisionit dhe qëndrimit të këtij të fundit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në përcaktimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ishte në

përmbushje të kërkesave të nenit 89, germa “b” e Kodit të Procedurave Administrative, për t’u vlerësuar si rast përjashtimor nga e drejta për ta dëgjuar subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, sa kohë pala e interesuar (subjekti i rivlerësimit në këtë rast) kishte paraqitur paraprakisht mendime, komente dhe shpjegime të plota gjatë procedurës, të cilat lidheshin jo vetëm me hetimet e kryera dhe vlerësimin e provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, por edhe me rezultatin e mundshëm të procedurës administrative, që në rastin objekt gjykimi ishte ndërprerja e procesit të rivlerësimit dhe ndalimi i ushtrimit të funksioneve të përcaktuara shprehimisht në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për një periudhë prej 15 vitesh. Pavarësisht sa më sipër, në kushtet kur Komisioni kishte marrë vendim për caktimin e seancës dëgjimore, të cilën e kishte njoftuar rregullisht, në vlerësimin e trupit gjykues, do duhet ta kishte zhvilluar atë duke konstatuar eventualisht mungesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, referuar njoftimit paraprak të saj sipas komunikimit të datës 17.03.2023, për sa kohë nuk rezultoi të ketë marrë vendim për ndryshimin/revokimin e vendimit të tij nr. {***}, datë 17.03.2023, “Për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla”. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të parregullt procedurën e ndjekur nga ana e Komisionit dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, por, në konsideratë të sa më sipër konstatuar, çmoi se kjo parregullsi nuk ka cenuar thelbin e së drejtës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me interesat e saj të ligjshëm në këtë procedurë hetimi administrativ.

23. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, se koha “tepër e kufizuar” e lënë në dispozicion nga Komisioni në kuadër të procedurës së rivlerësimit, vlerësuar kjo në raport me kohën e marrë nga Komisioni për zhvillimin e kësaj procedure, i vendoste, sipas saj, një barrë dukshëm joproporcionale në raport me konkluzionin përfundimtar të procesit ndaj subjektit, si në aspektin e rezultateve të deritanishme, ashtu edhe në atë të pritshmërive të saj profesionale, u çmuan nga trupi gjykues si të pabazuara në fakte. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi para trupit gjykues cenimin e të drejtave të saj si pasojë e afateve të ngushta kohore të vendosura nga Komisioni, sa kohë rezultoi se ajo kishte përmbushur çdo kërkesë të Komisionit në kuadër të mbrojtjes së interesave të saj të ligjshëm brenda afateve të përcaktuara, nuk rezultoi të kishte qenë në kushtet e pamundësisë për të respektuar afatet e vendosura nga ana e Komisionit, apo që kërkesat e saj eventuale për shtyrje të afateve të ishin rrëzuar me pasojë cenimin e së drejtës së saj për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në këtë procedurë hetimi administrativ.
24. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të cenimit të së drejtës për t’u mbrojtur në mënyrë efektive, nuk gjendet i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, nuk përbën shkak për cenueshmërinë e vendimit të Komisionit objekt ankimi.
25. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, pretendoi se Komisioni nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, duke qenë se, sipas saj, mungon arsyetimi logjik, ka referenca ligjore e fakte të gabuara, mungon analiza kushtetuese për të arritur në përfundimin e shprehur në pjesën urdhëruese të

vendimit, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴, e cila ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara.

26. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, fillimisht sa u takon elementeve formale të vendimit të Komisionit, trupi gjykues, pasi kontrollon vendimin objekt ankimi, konstatoi se ai ka respektuar strukturën e përcaktuar në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, ndonëse vërehet se elemente si “mendimi i subjektit të rivlerësimit”, mund të ishin elaboruar më shumë në funksion të transparencës për publikun, por pavarësisht sa më sipër, kjo mënyrë të vepruarit e Komisionit nuk çmohet se ka cenuar thelbin e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për akses në gjykatë. Konstatimi i disa pasaktësive në të shprehur nga ana e Komisionit, siç është detyra që ka ushtruar subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, e cila herë shprehet si ndihmëse ligjore dhe herë si këshilltare ligjore, nuk u vlerësua se cenon vendimin e Komisionit, sa kohë nuk konstatohet që ky dallim terminologjie të pasjellë një trajtim të ndryshëm ligjor. Trupi gjykues arriti në të njëjtin përfundim edhe sa i takon faktit se në vendimin objekt ankimi, trupi gjykues i është referuar një dispozite ligjore e cila u përkiste akteve ligjore të cilat në kohën e dhënies së vendimit nuk kanë pasur fuqi juridike, situatë të cilën e vlerësoi si një gabim material të Komisionit, sa kohë situata faktike për të cilën në vendim është bërë referimi në dispozitën e Kodit të mëparshëm të Procedurave Administrative, gëzon të njëjtin përcaktim ligjor në Kodin e Procedurave Administrative në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, duke mos krijuar dyshime mbi arsyet e referimit të kësaj dispozite për nevojat e vendimmarrjes objekt shqyrtimi.
27. *Sa i takon shkakut të ankimit për vendim të marrë si pasojë e zbatimit të gabuar të Kushtetutës dhe interpretimit të gabuar të fakteve e provave*, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit në mbështetje të këtij shkakut ankimi, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si vijon.

27.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, Komisioni ka vlerësuar kryesisht ndërprerjen e procesit për shkak dorëheqjeje, shoqëruar me pasojën juridike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, ndërkohë që sipas saj, sikundër është pranuar edhe në vendim, emërimi në pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore nuk është bërë bazuar në kërkesën e saj, ajo

⁴ *Shih vendimet nr. {***}, datë 26.01.2015, nr. {***}, datë 23.09.2015, nr. {***}, datë 25.04.2016, nr. {***}, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.*

nuk ka marrë pjesë në ndonjë procedurë konkurrimi, nuk ka paraqitur dorëheqje e as ndonjë akt shprehjeje vullneti për dhënie pëlqimi nga ana e saj.

27.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, pretendoi se analiza juridike nëse dorëheqja e saj përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, është sipërfaqësore, me interpretime në kundërshtim me Kushtetutën dhe me faktet e provat e administruara gjatë procesit. Sipas saj, interpretimi i Komisionit mbi qenien në kushtet e dorëheqjes duke shprehur në heshtje vullnetin, apo për shkak të mosshprehjes së mosdakordësisë për pozicionin e ri, nuk përmbush kriteret e pikës 1 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

27.3. Subjekti pretendoi gjithashtu se në mungesë të një akti dorëheqjeje dhe shprehjes së vullnetit të pavesuar për të ndërprerë marrëdhënien e punës si ndihmëse ligjore, në gjykimin e saj kjo marrëdhënie pune ka përfunduar për arsye ligjore nga një akt juridik i nxjerrë nga organi kompetent. Sa i takon moskundërshtimit gjyqësish të urdhrin të emërimit si oficerë e policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, u shpreh se në analizë të dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin për policinë gjyqësore, kushtet për të cilat akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm parashikohen në mënyrë eksplicite në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative dhe akti në fjalë nuk mund të goditej bazuar në këto shkaqe. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, nuk mund të shprehet nëpërmjet qëndrimit në detyrë, kur këtë detyrë nuk mund ta ushtrosh për arsye të pavarura nga vullneti yt.

27.4. Subjekti pretendoi edhe se vendimi i Komisionit është i pabazuar dhe keqinterpreton deri në shtrembërim faktet dhe provat e administruara nga vetë Komisioni, në shkelje flagrante të parimeve të objektivitetit, drejtësisë dhe paanësisë, të cilave u nënshtrohet procedura administrative.

28. Në shqyrtimin e këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 01.02.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, është emëruar oficerë e policisë gjyqësore në Sektorin e Studimeve, Kërkimeve, Analizës dhe Integritit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky urdhrë rezulton të ketë hyrë në fuqi menjëherë. Në këto kushte, vlerësohet se emërimi në detyrën e oficerës së policisë gjyqësore dhe, rrjedhimisht, mosushtrimi i detyrës që i dha znj. Ornela Xhembulla cilësinë e subjektit të rivlerësimit *ex officio* kanë prodhuar në datën 1 shkurt 2017, si pasojë, humbjen e kësaj cilësie. Për pasojë, ndërprerja e procesit të rivlerësimit nga Komisioni, kryesisht, pa kërkesë të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit në këtë drejtim⁵.
29. Në vijim të sa më sipër, lind nevoja e verifikimit nëse humbja e cilësisë së subjektit të rivlerësimit *ex officio* është për shkak të dorëheqjes së subjektit (vullnetit të pavesuar të subjektit), çka imponon vendimmarrjen e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, apo nëse cilësia e subjektit të rivlerësimit *ex officio* ka humbur për shkaqe ligjore të pavarura nga subjekti i rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, procesi duhet ndërprerë pa një vendimmarrje

⁵ Shih vendimin e Kolegjit nr. 17 (JR), datë 25.07.2019.

përfundimtare sa i takon çështjes së rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative.

30. Në kuadër të analizës së mësipërme, referuar akteve të fashikullit të çështjes në lidhje me dinamikën e hetimit të kryer nga Komisioni dhe fakteve lidhur me kalimin nga pozicioni i ndihmëses ligjore në atë të oficeres së policisë gjyqësore, si dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi në kohën e emërimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, në detyrën e oficeres së policisë gjyqësore, trupi gjykues konstatoi se nga hetimi i kryer, subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar të ketë dhënë dorëheqjen nga detyra e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet një akti formal, për rrjedhojë çmohet se referimi në vendimin e Komisionit, i vendimmarrjes së Kolegjit nr. 21, datë 17.06.2022 (JR), që i përket çështjes së subjektit të rivlerësimit S. Z. (siç me të drejtë pretendoi dhe subjekti i rivlerësimit), është irrelevant, sa kohë konstatohet që në ndryshim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, z. S. Z. ka bërë kërkesë drejtuar titullarit të institucionit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke bërë që këto dy çështje rivlerësimi të mos kenë situatë faktike të njëjtë.
31. Akti i emërimit të znj. Ornela Xhembulla si oficer e policisë gjyqësore, i cili njëkohësisht ka sjellë pasojën e përfundimit të detyrës si ndihmëse ligjore (dhe për rrjedhojë humbjen e cilësisë së subjektit të rivlerësimit *ex officio*), është një akt administrativ individual i Prokurorit të Përgjithshëm, i nxjerrë në mosrespektim të procedurës së përcaktuar në nenin 10/a të ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar, sipas të cilit: *Caktimi në seksionet e Policisë Gjyqësore bëhet bazuar në një procedurë konkurrimi [...] nga Prokurori i Përgjithshëm, në rastin e juristëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme të ekspertizës.*
32. Në vijim të sa më sipër, në kuadër të analizës mbi përmbushjen e kriterëve për zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, në kontekstin edhe të orientimit të dhënë nga ana e Kolegjit për verifikimin e vullnetit për dorëheqjen e subjekteve të rivlerësimit, konstatimi i mungesës së një akti formal të shprehjes së vullnetit për dorëheqje nga detyra, sikundër dhe mungesa e një akti formal të dhënies së pëlqimit për të ushtruar detyrën e re, nuk mund ta përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga përcaktimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultoi që emërimi në detyrën e re të oficerit të policisë gjyqësore nuk është kundërshtuar as në rrugë administrative dhe as në rrugë gjyqësore, edhe pse subjekti e kishte këtë mundësi ligjore për shkak të mungesës së procedurës së konkurrimit të kërkuar shprehimisht nga ligji. Një sjellje e tillë e subjektit me të drejtë është vlerësuar nga Komisioni si shprehje në heshtje e vullnetit të subjektit të rivlerësimit⁶, znj. Ornela Xhembulla, për t’u larguar nga detyra e ndihmëses ligjore dhe njëkohësisht për t’u shmangur nga procesi i rivlerësimit kalimtar, për sa kohë rikthimi në detyrën që e mbante znj. Ornela Xhembulla në procesin e rivlerësimit, nëpërmjet ankimimit, ishte një mundësi ligjore, e përjashtuar me vullnetin e saj të lirë.
33. Në vijim të analizës së mësipërme, përfundimi i marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, si ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme nuk ka ndodhur për shkaqe ligjore referuar parashikimit të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, procesi i

⁶ *Shih pjesën e fundit të paragrafit nr. 23.4 të vendimit të Komisionit.*

rivlerësimit nuk mund të deklarohet i përfunduar pa një vendim përfundimtar, por veçse të ndërpritet në zbatim të përcaktimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, siç me të drejtë ka vlerësuar edhe Komisioni në vendimin objekt ankimi.

34. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 645, datë 11.04.2023, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 645, datë 11.04.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Xhembulla.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.07.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi